

Vendim nr. 196 datë 16.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 16.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 18 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: FATBARDHA PETERÇI, HASAN ROQI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 6865, datë 26.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallë së Parë Tiranë; nr. 1612, datë 13.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4043, datë 17.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2024-3994, datë 17.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2025-1651, datë 30.04.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për çështjen “Detyrimin e organit publik, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, të më japë informacionin e refuzuar prej tij, në shkelje të së drejtës së informimit, për subjektet në funksione shtetërore”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Paraqitja e të dhënave të kërkuara në proceset e mësipërme në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 42, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për të vijuar në seancë plenare shqyrtimin e kërkesave të tjera, sipas

objekteve nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën i vendimeve nr. 26, datë 02.11.2005 dhe nr. 11, datë 04.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese, drejtpërdrejt të zbatueshme për kërkuesin, sipas nenit 4, pika 3; nenit 132, pikat 1 e 2, të Kushtetutës dhe pikës 3, shkronja “e”, të nenit 49; nenit 72, pika 7; nenit 76, pikat 1 e 3; nenit 81, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në lidhje me nenin 16 të ligjit nr. 9719, datë 23.04.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, ku anëtarët e qeverisë dhe të parlamentit, të cilët kishin privatizuar me kontratë qiraje me shtetin apartamente shteti në konflikt me ligjin e interesit, pas 19 ditësh të vendimit nr. 11/2007 të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizuan me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, pa zgjidhur udhëzimet e vendimeve nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës Kushtetuese, duke pasur në dispozicion 8000 (tetëmijë) apartamente, duke shkelur hapur barazinë përpara ligjit, grabitur dhe diskriminuar 4154 familje, ku bën pjesë kërkuesi.

Kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën i vendimeve nr. 26, datë 02.11.2005 dhe nr. 11, datë 04.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese, drejtpërdrejt të zbatueshme për kërkuesin, sipas nenit 4, pika 3; nenit 132, pikat 1 e 2, të Kushtetutës dhe pikës 3, shkronja “e”, të nenit 49; nenit 72, pika 7; nenit 76, pikat 1 dhe 3, nenit 81, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në lidhje me aktin normativ nr. 3, datë 01.08.2012 “Për lirimin

e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar”, ligjit nr. 82/2012, datë 13.09.2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar”, i votuar e lënë në fuqi në Gjykatën Kushtetuese me vendimin nr. 1, datë 06.02.2013, ku anëtarët e qeverisë, parlamentit dhe Gjykatës Kushtetuese, të cilët kishin privatizuar me kontratë qiraje me shtetin apartamente shteti, në konflikt me ligjin e interesit, kanë shkelur vendimet nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kërkonin privatizim banese në kushte të barabarta me 238 700 familjet, në shkelje të pikës 1 të nenit 82 të Kushtetutës, në shpërdorim të fondeve të buxhetit të shtetit për dhënie kredie të paligjshme, duke pasur në dispozicion 8000 (tetëmijë) apartamente, duke shkelur hapur barazinë përpara ligjit, grabitur dhe diskriminuar 4154 familje, ku bën pjesë kërkuesi.

Rehabilitimi dhe zhdëmtimi i kërkuesve në përputhje me nenin 44 të Kushtetutës, për shkak të dëmtimit nga veprimet e paligjshme antikushtetuese të shtetit.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, pikat 1 dhe 2, 17, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1, 2 dhe 3, 23, pikat 1 dhe 2, 25, 33, 35, pikat 1 dhe 2, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, pika 1, 8, pikat 1 dhe 2, 13, 14, 17 e 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 e Protokollit nr. 16 të saj; nenet 1, pika 2, 26, pikat 1 e 2, 27, pikat 1, 2 e 3, 39, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 43/b, pikat 1 e 2, 48, pikat 1 e 2, 49, pikat 3, shkronja “e” dhe 4, 71, 71/a, pikat 1 e 2, 72, pika 7, 76, pikat 1 dhe 3, 81, pikat 1-4, 86, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe

funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit S.R., i cili nga viti 1989 ka banuar si qiramarrës kryesor në një banesë në qytetin e Tiranës, në të cilën ka bërë disa shtesa anësore. Me vendimin nr. 314, datë 11.04.1994 (*vendimi nr. 314/1994*), Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë (*KKKP*) ka miratuar kërkesën e ish-pronarit Xh.K. për kthimin e banesës dhe shtesave të ndërtuara në oborrin e saj, duke përcaktuar se, në kushtet kur vlera e shpenzimeve të shtesës anësore të ndërtuar nga babai i kërkuesve përbënte 11,7% të vlerës së banesës, pra ishte nën 20%, shtesa i kthehej ish-pronarit Xh.K. pa kundërshtim, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Pas ankimit të këtij vendimi nga S.R., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1666, datë 16.04.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2227, datë 08.10.1997, në të cilin vlera e shpenzimeve është njohur në masën 37%. Më pas, vendimi i gjykatës së apelit është lënë në fuqi me vendimin nr. 489, datë 26.03.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndërsa me vendimin nr. 17, datë 09.02.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur mospranimin e rekursit në interes të ligjit të paraqitur nga S.R. Vendimmarrjet e gjykatave të zakonshme janë bërë edhe objekt i kontrollit të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 76, datë 08.11.2000 (*vendimi nr. 76/2000*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës së S.R. për shfuqizimin si antikushtetuese të tyre, me arsyetimin se nuk ndodhej përpara një procesi të parregullt ligjor dhe se pretendimet e kërkuesit ishin të natyrës ligjore e jo kushtetuese.

2. Me pretendimin se vendimet gjyqësore kishin njohur të drejtën e pronësisë për banesën e shtetasit S.R., ky i fundit/trashëgimtarët e tij u janë drejtuar gjykatave me procese të ndryshme, disa nga të cilat janë bërë edhe objekt kontrolli kushtetues nga Gjykata, Kolegjet e saj ose Mbledhja e Gjyqtarëve.

3. Në datën 18.06.2014, bazuar në ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” (*ligji nr. 8503/1999*), ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (*ligji nr. 9367/2005*) dhe ligjin nr. 9887, datë 20.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar (*nr. 9887/2008*), S.R. u është drejtuar inspektorit të lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Entit Kombëtar të Banesave (EKB) me kërkesë për njohjen me dokumentet e administruara në arkivat e këtyre institucioneve, me qëllim marrjen e informacionit nëse 80 punonjës zyrtarë konkretë, subjekte të deklarimit të pasurive, drejtpërdrejt ose përmes prindërve të tyre, kishin përfitur banesë në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (*ligji nr. 7652/1992*). Në kërkesë S.R. ka pretenduar se privatizimi i banesave shtetërore nuk ishte bërë për shkak të cilësive të veçanta ose ndonjë kontributi specifik të subjekteve përfituese dhe, duke qenë se ligji kishte qenë transparent, i hapur e publik, marrja të dhënave që u përkiste këtyre personave nuk përbënte cenim të privatësisë së tyre.

4. Me shkresën nr. 3513/1 prot., datë 23.06.2014 të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), S.R. është informuar se kërkesa e tij nuk mund të përmbushej për shkak të volumit të punës, si rrjedhojë e proceseve të nisura për kontrollin e plotë të pasurive të një numri të madh zyrtarësh objekt deklarimi, dhe se për këtë qëllim duhej t’i drejtohej EKB-së, si institucioni që kishte lëshuar dokumentacionin e kërkuar. Ndërsa me shkresën nr. 1911/1 prot., datë 30.06.2014 të EKB-së, S.R. është informuar se ky institucion nuk ka pasur kompetencë për privatizimin e banesave shtetërore, ndaj nuk dispononte dokumentacion për këtë proces, por ky dokumentacion mund të ndodhej në zyrat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore.

5. Në datën 07.04.2014 S.R. i është drejtuar ILDKPKI-së me kërkesë për njohjen me deklaratimet e 80 të zgjedhurve dhe gjyqtarëve të lartë. Me shkresën nr. 3513/3, datë 18.07.2014 të ILDKPKI-së ai është informuar se, ndërsa ky institucion administron deklaratat e interesave privatë dhe kontrollonte ligjshmërinë e burimit të pasurive të deklaruara, nuk përpunonte të dhëna lidhur me asetet e tyre dhe nuk dispononte regjistër të veçantë në këtë drejtim. Në kushtet e pamundësisë për të përpunuar informacionin e kërkuar, ashtu siç ishte informuar nga EKB-ja, S.R. duhej t’u drejtohej zyrave përkatëse të qeverisjes vendore.

6. Në vijim, në datën 30.07.2014 S.R. i është drejtuar sërish ILDKPKI-së me kërkesë për njohjen me deklaratimet e zyrtarëve publikë. Me shkresën nr. 3513/5, datë 07.08.2014, ILDKPKI-ja e ka informuar se ajo bënte publikimin e deklaratave periodike të interesave

privatë të zyrtarëve që ushtronin funksione publike dhe personave të lidhur me ta, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 16, datë 11.11.2004 (*vendimi nr. 16/2004*) të Gjykatës, pasi aktet ligjore e nënligjore nuk parashikonin mënyra të tjera për publikimin e tyre.

7. Në kushtet e mosdhënies së informacionit të kërkuar, në datën 18.09.2014 S.R. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e ILDKPKI-së për dhënien e tij. Sipas S.R., subjektet për të cilat kërkonte informacion kishin krijuar, nxjerrë, miratuar, ligjëruar, gjykuar e dekretuar aktin normativ nr. 3, datë 01.08.2012 “Për lirimimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar” (*akti normativ nr. 3/2012*), si dhe ligjin nr. 82/2012, datë 03.09.2012 “Për miratimin e aktit normativ nr. 3, datë 01.08.2012 “Për lirimimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”” (*ligji nr. 82/2012*), të lënë në fuqi me vendimin nr. 1, datë 06.02.2013 (*vendimi nr. 1/2013*) të Gjykatës.

8. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesëpadisë, me vendimin nr. 6865, datë 26.11.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj e në prova, duke vlerësuar se: (i) mosdhënia e informacionit nga ILDKPKI-ja ishte bërë për shkak se S.R. nuk kishte tagër për kërkimin e tij dhe nuk ishte përfaqësues ligjor; (ii) përgjigjet e ILDKPKI-së kishin synuar mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve deklaruese, në zbatim korrekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vendimit nr. 16/2004 të Gjykatës; (iii) bazuar në urdhrin nr. 997, datë 18.06.2014 “Për publikimin e deklaratave të interesave privatë” (*urdhri nr. 997/2014*) të inspektorit të përgjithshëm të ILDKPKI-së, të nxjerrë mbi bazën e vendimit nr. 16/2004 të Gjykatës, ky institucion publikonte vetëm deklaratën, duke hequr të dhënat konfidenciale; (iv) publikimi i deklaratës dhe përpunimi i të dhënave të saj për qëllime të kërkesës së S.R. përbënin koncepte të ndryshme. Kundër këtij vendimi S.R. ka ushtruar ankim.

9. Me vendimin nr. 1612, datë 13.04.2017, me të njëjtin arsyetim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj. Kundër këtij vendimi S.R. ka ushtruar rekurs në datën 15.05.2017, ndërsa ka ndërruar jetë në datën 29.04.2018. Rekursi i tij është regjistruar me nr. 31003-02876-00-2017 në Regjistrin Themeltar të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 16.10.2024 kërkuesi Hasan Roqi, në cilësinë e trashëgimtarit të S.R., i është drejtuar kryetarit të Gjykatës së Lartë me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A.V. nga shqyrtimi i rekursit, duke pretenduar, ndër të tjera, se për shkak të kallëzimit penal të paraqitur

ndaj këtij gjyqtari, në lidhje me tjetër çështje, pjesëmarrja e tij në shqyrtimin e çështjes konkrete e vinte atë gjyqtar në pozita hakmarrëse. Po kështu, në kërkesë ai ka kërkuar edhe që, bazuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen të deklaronte nëse ata vetë ose prindërit e tyre kishin privatizuar banesa shtetërore në kontratë qiraje me shtetin dhe, nëse po, të mos merrnin pjesë në shqyrtimin e çështjes.

11. Me vendimin nr. 00-2024-4043, datë 17.10.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (gjyqtari i vetëm i saj) ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit A.V., me argumentin se ajo ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Ndërsa për rekursin e S.R., me vendimin nr. 00-2024-3994 (412), datë 17.10.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, duke e gjetur atë në interpretim të drejtë të legjislacionit në fuqi dhe vendimit nr. 16/2004 të Gjykatës.

12. Në datën 20.02.2025 kërkuesi Hasan Roqi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 00-2024-3994 (412), datë 17.10.2024 të Kolegjit Administrativ të saj, ndreqjen e gabimeve e korrigjimin e tyre dhe plotësimin e arsytimit të tij. Me vendimin nr. 00-2025-1651, datë 30.04.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, ndreqjen e gabimit material në paragrafin 3 të vendimit dhe rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër të saj.

13. Në datën 17.05.2025 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 04.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuessve

14. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

14.1. *E drejta për informim*, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi ILDKPKI-ja dhe gjykatat kanë refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar, në shkelje të Kushtetutës dhe ligjit. Këto organe nuk kanë kontribuar në përmbushjen e së drejtës kushtetuese për informim, duke cenuar nenet 15, pikat 1 e 2 dhe 17, pikat 1 e 2, të Kushtetutës. Subjektet për të cilat kërkohej informacioni u nënshtroheshin kontrollit dhe deklarimit të pasurive e interesave dhe, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, për shkak të funksionit publik që kanë mbajtur,

kanë rënë dakord që këto të dhëna të ishin publike. Të dhënat e kërkuara nuk përmbanin informacione konfidenciale të jetës private të subjekteve deklaruese dhe as sekrete shtetërore, nxjerrja e të cilave do të cenonte thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të tyre ose integritetin e shtetit.

14.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi janë diskriminuar për shkak të së kaluarës së tyre si të përndjekur politikë, duke u ndodhur përpara një padrejtësie të madhe shoqërore.

14.3. *E drejta për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues*, e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, pasi ata dhe familja e tyre, përfshirë dy pleq në moshën 85-vjeçare, janë nxjerrë nga banesa me forcë në mes të dimrit nga forcat policore e civile.

14.4. *Neni 33 i Kushtetutës*, pasi ILDKPKI-ja dhe gjykatat kanë marrë në mbrojtje subjektet që ushtronin funksione publike dhe për të cilat kërkohej informacioni, duke fshehur veprat e tyre përpara drejtësisë.

14.5. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi, për shkak të interesave të subjekteve në konflikt të rëndë interesi u është hequr e drejta për pronën dhe për ta fituar atë në barazi me të gjithë qytetarët e tjerë. Në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, kjo e drejtë u është cenuar përmes një procesi antikushtetues e antiligjor, në shkelje të vendimeve nr. 26, datë 02.11.2005 (*vendimi nr. 26/2005*) dhe nr. 11, datë 04.04.2007 (*vendimi nr. 11/2007*) të Gjykatës.

14.6. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

14.6.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi: (i) Gjykata e Lartë ka pranuar dorëheqjen e gjyqtarit A.V. nga shqyrtimi i rekursit për çështjen me nr. 31003-01641-00-2017 të regjistrit të saj, datë 20.06.2017, për shkak të qenies së tij anëtar i trupit gjykues që ka gjykuar në apel një tjetër çështje të shtetasit S.R., ndërsa nuk ka pranuar kërkesën për përjashtimin e tij nga shqyrtimi i çështjes konkrete, edhe pse ai gjyqtar ishte kallëzuar penalisht në SPAK nga kërkuesi; (ii) gjyqtari i Gjykatës së Lartë G.M. ishte në kushtet e konfliktit të interesit për gjykimin e çështjes, pasi, sipas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të dhënë për këtë gjyqtar, prindërit e tij kishin privatizuar banesë në kontratë me shtetin.

- 14.6.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi: (i) vendimi i gjykatës së apelit është kopje e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në shkelje të nenit 142, pika 1, të Kushtetutës dhe praktikës kushtetuese e gjyqësore që kërkon arsyetimin e vendimit gjyqësor, duke i hequr në këtë mënyrë të drejtën e një shkalle gjykimi; (ii) Gjykata e Lartë nuk është shprehur për kërkesën e kërkuarit që trupi gjykues i saj të deklaronte nëse ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit, si rrjedhojë e privatizimit nga anëtarët ose prindërit e tyre të banesave shtetërore me kontratë qiraje me shtetin; (iii) argumenti i përdorur nga Gjykata e Lartë për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit me arsyetimin e rrezikshmërisë shoqërore e kriminale të kërimit të adresave të subjekteve deklaruese dhe ekzistencës së dyshimeve se paditësi mund të ushtrojë veprimtari kriminale ndaj tyre nuk qëndron, pasi në kërkesë S.R. ka kërkuar që ILDKPKI-ja të shprehet me një “po” ose “jo” dhe nuk ka kërkuar adresë të subjekteve deklaruese. Të dhënat e nxjerra nga numërimi telefonik janë paraqitur nga S.R. për të ndihmuar ILDKPKI-në dhe gjykatën në transparencën e procesit.
- 14.7. *Parimi i ligjshmërisë*, pasi akti normativ nr. 3/2012 dhe ligji nr. 82/2012 janë nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit të miratuesve të tyre, në kundërshtim me vendimet nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës, të cilat ishin drejtpërdrejt të zbatueshme dhe përcaktonin trajtim të barabartë të 4.157 familjeve me 238.700 familjet, në kushtet kur shteti kishte në dispozicion 8.000 apartamente. Subjektet deklaruese për të cilat është kërkuar informacioni kanë lënë në fuqi aktin normativ nr. 3/2012 në konflikt të rëndë interesi me ligjin nr. 9367/2005.
- 14.8. *E drejta për t’u rehabilituar*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi kërkuarit duhet të zhdëmtohen në përputhje me vendimet nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës, për shkak të veprimeve antikushtetuese dhe të paligjshme të organeve shtetërore.
- 14.9. *Neni 132, pikat 1 dhe 2, i Kushtetutës*, pasi veprimet e subjekteve mbajtëse të funksioneve publike, në konflikt interesi, kanë cenuar rolin dhe pozicionin e Gjykatës, si mbrojtëse e Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesve

15. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se në objektin të ankimit kushtetues individual kërkuarit kanë kërkuar kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës, duke pretenduar se anëtarët e qeverisë dhe të Kuvendit, të cilët në konflikt me ligjin kanë privatizuar në kontratë me shtetin apartamente shtetërore, kanë shfuqizuar ligjin nr. 7652/1992 pa pasur parasysh udhëzimet e vendimeve nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës, të cilat kërkonin privatizim banese në kushte të barabarta me 238.700 familje, duke diskriminuar e grabitur 4.154 familje, ku bënte pjesë edhe shtetasi S.R., si dhe në shpërdorim të fondeve të shtetit, në kundërshtim me neni 82, pika 1, të Kushtetutës.

18. Kolegji vë në dukje se Kushtetuta, në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, shprehet qartësisht për forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë se vendimet e kësaj Gjykate kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Efekti detyrues

i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë ajo (*shih vendimet nr. 11, datë 15.02.2018; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në kushtet kur vendimmarrja e Gjykatës nuk mund të bëhet objekt i kontrollit të saj, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen në aspektin procedural për kërkimet për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007 të Gjykatës.

19. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesit kanë kërkuar edhe shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore të dhëna për kërkesën e S.R. (babai i tyre) për informim lidhur me mënyrën e përfitimit të pasurive të disa subjekteve deklaruese, si dhe rehabilitimin e tyre, si rrjedhojë e dëmtimit nga veprimet e paligjshme të ILDKPKI-së dhe gjykatave. Për sa u përket këtyre kërkimeve, Kolegji vlerëson se, si trashëgimtarë ligjorë të shtetasit S.R., i cili ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ata legjitimohen *ratione personae* në aspektin procedural dhe substancial, pasi kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Një kriter tjetër ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, të parashikuara nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 10, datë 13.03.2025; nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, kërkuesit kanë pretenduar cenimin *së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues*, me argumentin se ata dhe familjarët e tyre janë nxjerrë nga banesa me forcë nga forcat policore e civile. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vëren se nga materialet e depozituara së bashku me ankimin kushtetues individual nuk rezulton që kërkuesit të kenë nisur procedim penal ose administrativ ndaj veprimeve të kryera nga organet ligjzbatuese. Në mungesë të një akti publik ose vendimi gjyqësor në këtë drejtim, sipas përcaktimit të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji çmon se në lidhje me këtë

pretendim kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës.

22. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vëren se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

23. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë i datës 17.10.2024, i është komunikuar kërkuesit Hasan Roqi në adresën e postës elektronike në datën 21.01.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë përmes shërbimit postar në datën 17.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

24. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar se ILDKPKI-ja dhe gjykatat e zakonshme u kanë cenuar të drejtën për informim, parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, nenin 33 të Kushtetutës, të drejtën e pronës, të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimin e ligjshmërisë, të drejtën për t'u rehabilituar dhe nenin 132, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

25. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Kolegji konstaton se ato për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, së drejtës së pronës, parimit të ligjshmërisë, si dhe nenin 132, pikat 1 e 2, të Kushtetutës kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e kërkuesve për pronën, e cila është bërë objekt analize e vlerësimi në procese të tjera gjyqësore, si dhe i është nënshtruar edhe kontrollit kushtetues (shih vendimet nr. 76, datë 08.1.2000; nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet nr. 138, datë 21.06.2023 të Kolegjit të Gjykatës e nr. 231, datë 06.11.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve). Në këto kushte, për sa kohë që Gjykata është shprehur më parë për këto pretendime, Kolegji vlerëson se, në kuptim të nenit 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577/2000, ato nuk mund të merren në shqyrtim.

26. Në ankimin kushtetues individual kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për shkak të: (i) mospranimit nga Gjykata e Lartë të kërkesës së tyre për përjashtimin e një anëtari të trupit gjykues të saj, ndërsa ka

pranuar dorëheqjen e tij nga gjykimi i një tjetër çështjeje të shtetasit S.R.; (ii) konfliktit të interesit të një anëtarit tjetër të trupit gjykues të kësaj gjykate, si rrjedhojë e privatizimit nga prindërit e tij të banesës në kontratë me shtetin.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se respektimi i *parimit të paanshmërisë*, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë. Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin konkret, për sa i përket *shkakut të parë* të paanshmërisë, mospranimit të kërkesës për përjashtimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë, Kolegji evidenton se, pas marrjes së mendimit nga gjyqtari në fjalë, i cili ka deklaruar se pretendimet e kërkuësve për tendenca hakmarrëse të tij ishin të pabazuara dhe se vendimmarrjet e mëparshme për çështjet e S.R. nuk kishin asnjë lidhje me çështjen në shqyrtim, me vendimin e gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Lartë është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuësve për përjashtimin e tij nga shqyrtimi i çështjes, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 72 i KPC-së. Në analizë të vendimit të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ai nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, për sa kohë që proceset për të cilat është kërkuar përjashtimi i anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë kanë pasur objekte dhe palë të ndryshme dhe kanë qenë të ndryshme në thelb. Kështu, procesi objekt ankimi kushtetues individual konkret ka pasur për objekt të drejtën e informimit, me palë kundërshtarë ILDKPKI-në, ndërsa procesi i regjistruar me nr. 31003-01641-00-2017 të Gjykatës së Lartë, në të cilin është pranuar dorëheqja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ka pasur për objekt detyrimin e shpërblimit të dëmit moral dhe material dhe palë kundërshtarë Zyrën Vendore dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në këtë situatë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si

rrjedhojë e pjesëmarrjes në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë të një gjyqtari për të cilin kishte kërkuar përjashtimin, është haptazi i pabazuar.

29. Për sa i përket *shkakut të dytë*, ekzistencës së konfliktit të interesit të një gjyqtari tjetër të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, si rrjedhojë e privatizimit nga prindërit e tij të banesave në kontratë me shtetit, Kolegji çmon se kërkuesit nuk kanë arritur të përcaktojnë, në kuptim të testit objektiv dhe subjektiv të paanshmërisë, cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme për këtë shkak. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesve është haptazi i pabazuar. Me të njëjtin arsyetim, Kolegji çmon se në ankimin kushtetues individual kërkuesit nuk kanë arritur të përcaktojnë cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, si rrjedhojë e mosarsytimit në vendimin e Gjykatës së Lartë nëse anëtarët e trupit të saj gjykues ndodheshin në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të privatizimit të banesave shtetërore nga prindërit e tyre, për rrjedhojë ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për informim, të nenit 33 të Kushtetutës, së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për rehabilitim. Duke mbajtur në konsideratë se këto pretendime mbështeten, në thelb, në të njëjtat argumente, dhe se ato parashtrohen në kuadër të procesit gjyqësor të zhvilluar për kërkesëpadinë e paraqitur nga babai i kërkuesve, S.R., në kuadër të së drejtës për informim, Kolegji çmon që në vijim t'i analizojë ato së bashku në këndvështrim të së drejtës për informim të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për informim të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkuesit kanë pretenduar se ILDKPKI-ja dhe gjykatat kanë refuzuar dhënien e informacionit të kërkuar nga babai i tyre, në shkelje të Kushtetutës dhe ligjit, edhe pse të dhënat e kërkuara për subjektet deklaruese ishin publike, nuk përmbanin informacione konfidenciale të jetës së tyre private dhe as sekrete shtetërore, nxjerrja e të cilave do të cenonte thelbin e lirive dhe të drejtave themelore të tyre ose integritetin e shtetit. Po sipas kërkuesve, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të njëjtin arsyetim, gjykata e apelit u ka hequr të drejtën për një shkallë gjykimi. Ndërsa argumenti i përdorur nga Gjykata e Lartë për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit me arsyetimin e rrezikshmërisë shoqërore e kriminale të kërkimit të adresave të subjekteve deklaruese dhe ekzistencës së dyshimeve se paditësi mund

të ushtrojë veprimtari kriminale ndaj tyre nuk qëndron, pasi në kërkesë S.R. ka kërkuar që ILDKPKI-ja të shprehet me një “po” ose “jo” dhe nuk ka kërkuar adresë të subjekteve deklaruese. Të dhënat e nxjerra nga numërtori telefonik janë paraqitur nga S.R. për të ndihmuar ILDKPKI-në dhe gjykatën në transparencën e këtij procesi.

32. Neni 23, pikat 1 dhe 2, i Kushtetutës parashikon se e drejta e informimit është e garantuar dhe kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për personat që ushtrojnë funksione publike. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se e drejta e informimit garantohet nga neni 10 i KEDNJ-së (*liria e shprehjes*), si një e drejtë themelore për të marrë dhe për të dhënë informacion, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Përveç garancisë subjektive si e drejtë kushtetuese themelore, ajo është e lidhur objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Megjithatë, kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me nenin 35, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Po sipas Gjykatës, të dhënat pasurore të funksionarëve publikë janë vetiu nën vëzhgimin dhe vlerësimin e publikut dhe marzhi i vlerësimit në këtë rast është dhe duhet të jetë i gjerë e tolerues, pasi bëhet fjalë për persona të rëndësishëm publikë, të veshur me pushtet të konsiderueshëm shtetëror. Deklarimi i pasurisë dhe mundësia e publikimit të të dhënave të deklaratës në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, është gjithashtu një ndihmesë për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se në përputhje edhe me nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” (*ligji nr. 9049/2003*), si rregull bëhet publike ajo çka përbën thelbin e informacionit mbi pasurinë dhe burimet e saj të deklaruara nga subjekti përkatës, pa hyrë në detaje të panevojshme ose elemente të deklarimit që mund t’i shërbejnë për verifikim dhe kontroll ILDKPKI-së ose autoriteteve të tjera publike, por që në vetvete nuk paraqesin interes për publikun (*shih vendimin nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 13.03.2025; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*) Po kështu, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të

juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret, Kolegji vëren se neni 34 i ligjit nr. 9049/2003, sipas përmbajtjes së tij në fuqi në kohën e kërimit të informacionit nga S.R., parashikonte se të dhënat që përfitohen nga deklarimi i pasurisë janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjet nr. 8503/1999 e nr. 9887/2008, dhe se inspektori i përgjithshëm, në përputhje me këto ligje, përcakton procedurat sesi veprohet për publikimin e të dhënave të interesave privatë që deklarohen pranë Inspektoratit të Lartë për zyrtarët e personat e lidhur me ta. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, inspektori i përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr. 997, datë 18.06.2014 “Për publikimin e deklaratave të interesave privatë” (*urdhri nr. 997/2014*), duke përcaktuar se publikimi i të dhënave të interesave privatë për zyrtarët të cilët janë subjekte të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, bëhet kundrejt kërkesës së palës së interesuar (*pika 1*), si dhe se nuk janë pjesë e publikimit të deklaratës së interesave privatë informacionet konfidenciale, në përputhje me ligjin nr. 9887/2008, i ndryshuar dhe vendimin nr. 16/2004 të Gjykatës Kushtetuese (*neni 8*).

36. Po kështu, sipas përmbajtjes së kohës, ligji nr. 8503/1999 parashikonte se çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion mbi veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet dhe se autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe (*neni 3*). Gjithashtu, çdo person ka të drejtë të informohet për të dhënat vetjake të personave që kryejnë funksione shtetërore ose shërbime publike, të mbajtura në një dokument zyrtar, për aq sa këto të dhëna lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji ose nga një akt nënligjor për personat që i ushtrojnë këto detyra (*neni 5*). Ndërsa, sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në fuqi në kohën e kërimit të informacionit, çdo person kishte të drejtë që, pa pagesë, me kërkesë me shkrim, të merrte nga kontrolluesi, në një formë të kuptueshme, të dhëna personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre (*neni 12, pika 1, shkronja “b” - E drejta për akses*). Po sipas këtij ligji, të dhënat e regjistruara nuk përdorshin për qëllime të ndryshme, që nuk ishin në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohej njohja ose çdo përpunim i të dhënave të

regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për të garantuar sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin dhe hetimin e kryerjes së një veprë penale apo ndjekjen e autorëve të saj, ose për shkelje të etikës për profesionet e rregulluara (*neni 27, pika 3 “Masat për sigurinë e të dhënave personale”*).

37. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe parashikimeve ligjore në fuqi në kohën e kërimit të informacionit, Kolegji vëren se S.R. i është drejtuar ILDKPKI-së, duke kërkuar fillimisht njohjen me dokumentet e administruara nga ky institucion për 80 funksionarë publikë, subjekte deklaruese dhe, më pas, njohjen me deklaratimet e bëra prej tyre pranë këtij institucioni. Informacioni i kërkuar nuk i është vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja me argumentin se deklaratat periodike të interesave privatë të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta bëheshin publike, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 16/2004 të Gjykatës, qëndrim ky i cili është vlerësuar i drejtë në vijim nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit. Sipas këtyre të fundit, S.R. nuk kishte tagër për kërkimin e informacionit në fjalë dhe nuk ishte përfaqësues ligjor; informacioni i kërkuar mbrohej nga ligji për të dhënat personale; deklarata publikohej, sipas urdhrin nr. 997/2014 të inspektorit të përgjithshëm të ILDKPKI-së dhe publikimi i saj e përpunimi i të dhënave që ajo përmbante përbënin koncepte të ndryshme.

38. Në analizë të vendimit nr. 16/2004 të Gjykatës e kuadrit ligjor në fuqi përkundrejt vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta, si dhe duke vendosur në balancë të drejtën për informim me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se e drejta për të kërkuar informacion kufizohet nga ligjet nr. 8503/1999 dhe nr. 9887/2008. Sipas saj, rregullimi i ligjvënësit në nenin 34 të ligjit nr. 9049/2003 për mbajtjen parasysh të këtyre ligjeve nuk ishte i paqëllimshëm, pasi synonte të ndalonte keqpërdorimin nga individët të të drejtave subjektive në cenim të parimit të ligjshmërisë. Në këtë kontekst, sipas saj, të dhënat personale që bartin deklaratat e pasurisë përjashtohen nga publikimi, jo vetëm për të garantuar mbrojtjen e jetës private të subjekteve deklaruese (për të dhënat dhe detajet e panevojshme që nuk janë në interes të publikut), por edhe në funksion të ruajtjes së sigurisë e integritetit të tyre personal dhe familjar, si parakusht për ushtrimin konform ligjit të të drejtave dhe detyrimeve ligjore të çdo personi. Në referim të çështjes objekt gjykimi, Gjykata e Lartë ka evidentuar se kërkuesi nuk kishte kërkuar marrjen e dokumenteve që ILDKPKI-ja dispononte, por përpunimin e të dhënave të tyre, përmes kryerjes së një pune voluminoze për shqyrtimin e dokumenteve zyrtare, me qëllim nxjerrjen e të dhënave të kërkuara, proces për të

cilin ai nuk legjitimohej, sipas legjislacionit në fuqi, për vënien në lëvizje të ILDKPKI-së. Për më tepër, fakti nëse subjektet deklaruese ose familjarët e tyre kishin privatizuar banesa shtetërore nuk lidhet me cilësitë e kërkuara nga ligji ose aktet nënligjore për këta persona dhe nuk përbënte element me rëndësi për publikun. Procesi në fjalë ishte rregulluar nga një ligj i së drejtës publike dhe ishte zbatuar njëtrajtshmërisht për të gjitha kategoritë e shtetasve, pavarësisht nëse ishin ose jo funksionarë publikë. Rrjedhimisht, kërkesa e S.R. nuk gëzonte mbrojtje në kuptim të nenit 5 të ligjit nr. 8503/1999.

39. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar të drejtë mosdhënien nga ILDKPKI-ja të informacionit të kërkuar nga S.R., duke arsyetuar në thelb se kërkesa e tij nuk lidhet me të drejtën për t'u informuar për veprimet e kryera nga funksionarët publikë gjatë ushtrimit të detyrave shtetërore, pra nuk kishte të bënte me cilësitë ligjore të funksionarëve publikë, por me të dhëna private të këtyre subjekteve, të cilat mbroheshin nga legjislacioni në fuqi, konkretisht ligjet e kohës për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këndvështrim të këtyre vendimmarrjeve, Kolegji vlerëson se arsyetimi i gjykatave nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, për sa kohë që, në përputhje me vendimin nr. 16/2004 të Gjykatës, bërja publike e të dhënave pasurore të funksionarëve publikë është në funksion të kontrollit të ligjshmërisë së pasurive të tyre dhe parandalimit e shmangies së konfliktit të interesave. Në rastin konkret, informacioni i kërkuar nga S.R. nuk kishte të bënte me aspekte të këtij kontrolli, por me përfitimin ose jo nga subjektet e deklarimit të pasurive sipas ligjit nr. 7652/1992, pra përmes një procesi të ligjshëm të fitimit të pasurisë. Po ashtu, në kundërshtim nga sa kërkuarit pretendojnë, Kolegji vëren se në vendimet e tyre gjykatat kanë argumentuar për shkaqet që i kanë çuar në rrëzimin e kërkesës së S.R. për informacion, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimit të tij me natyrë kushtetuese, për rrjedhojë vendimet nuk rezultojnë në cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

40. Krahas sa më lart, Kolegji evidenton se me ligjin nr. 124/2024, datë 19.12.2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të përafruar me legjislacionin e BE-së, ligji nr. 9887/2008 është shfuqizuar (*neni 99, pika 1*), duke parashikuar tashmë se e drejta për akses në të dhënat personale i njihet jo më “çdo personi”, siç parashikonte neni 12 i ligjit nr. 9887/2008, por vetëm “subjektit të të dhënave”, pra individit që ato i përkasin (*neni 14*). Ndaj, edhe në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarve për cenimin e së drejtës për informim janë haptazi të pabazuara.

41. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuësve për cenimin e së drejtës për informim të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

42. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, “dh” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.